



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 23 Prot

Peshkopi, më 03.01.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.135


Datë: 29.12.2023

“Për nxjerrjen nga përdorimi i Aktiveve të qendrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2023, të Qendrës Kulturorë Dibër ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.15/1prot.

Peshkopi, më 05.01.2024

Lënda : Per vendimin nr. 135, datë 29.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër

BASHKISE DIBER


PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.135, date 29.12.2023 "Për nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për 2023, të Qendrës Kulturore Dibër ", konstatova ;

Në interpretim të dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative akti objekt shqyrtimi nuk përmban karakteristikat e një akti nënligjor normativ. Duke mos qenë akt nënligjor normativ vendimi nr. 135 datë 29.12.2023 i këshillit të bashkisë Dibër në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" nuk i nënshtrohet verifikimit për efekt ligjshmërie nga Prefekti.

Hyrja në fuqi e aktit objekt shqyrtimi nuk kushtëzohet nga firmimi apo kundërfirmimi i autoritetit të Prefektit.

Mënyra e hyrjes në fuqi të akteve administrative të kesaj natyre parashikohet në dispozita të tjera ligjore dhe është përgjegjesi direkte administrative - ligjore e strukturave përgjegjëse që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 135 Datë 29 / 12 /2023

“Për nxjerrjen nga përdorimi i Aktiveve të qendrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2023, të Qendrës Kulturore Dibër”.


Në mbështetje të ligjit nr. 139.2025 “Për vetëqeverisjen vendore” në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.10296 datë 08.07.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni IV, pika 71 deri 106, në urdhërin nr.29 datë 02.10.2023, “Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve të qendrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2023, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **29.12.2023**, me 24 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin për nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve të trupëzuara të Qendrës Kulturore Dibër, për të cilët komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimin propozon që janë jashtë funksionit të tyre.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës), pranë Qendrës Kulturore Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **29.12.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irini Shehu



BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i financës
PROJEKT – VENDIM
Nr. 16 Datë 20/12/2023

“PËR NXJERRJEN NGA PËRDORIMI I AKTIVEVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA DHE QARKULLUESE PËR VITIN 2023 TË QËNDRËS KULTURORE DIBËR

”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” neni IV ,pika 73 deri 106, në urdhërin nr.29 datë 02.10.2023 “ Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2023” :

Kërkojmë:

- Miratimin për nxjerjen nga përdorimi i aktiveve të trupëzuara të Qendrës Kulturore Dibër, për të cilat komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit propozon që janë jashtë funksionit të tyre.
- Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (sektori i financës) pranë Qendrës Kulturore Dibër.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR

P/S/Finanës
Albjola SHAHI





Kryetari i Bashkisë
Rahim SPAHIU

Drejtori
Igli Tomçini



Në mungesë dhe me porosi
Nën kryetari i Bashkisë

Ruzhdi DEDA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
QENDRA KULTURORE DIBËR
(Sektori i Financës)

Adresa: Bulevardi "Elez Isuff", Peshkopi, Albania, nr.tel. 00355 218 2 25 16

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Dibër

Lenda : Kërkese për nxjerrje nga përdorimi të disa aktiveve të trupëzuara të Qendrës Kulturore Dibër

RELACION

Mbështetur në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 120, që citon: "Për efekte ekonomike dhe financiare të nxjerrjes nga përdorimi, njësitë e qeverisjes vendore duhet të informojnë këshillat e njësisë vendore", paraqesim informacionin e mëposhtëm mbi rezultatet e inventarizimit fizik të aseteve të Qendres Kulturore Dibër për vitin 2023.

Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhëra /udhëzime nga titullari i njësisë publike.

Inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurta u krye nga një komision i posaçëm i krijuar me urdhër nr. 29 date 02/10/2023 të Titullarit të njësisë shpenzuese, i ndryshuar në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2, neni 64 germa a, Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 22, pika 3, germa b, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 108, dt. 16.11.2016, Udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aseteve ne sektorin publik" , i ndryshuar.

Komisioni bëri inventarizimin fizik të aktiveve për të gjithë punonjësit që kanë në ngarkim aktive. Në përfundim të inventarizimit u hartua dokumentacioni përkatës mbështetur në Udhëzimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve duke cilësuar kushtet për nxjerrjen nga përdorimi.

Në zbatim të pikës 102 të udhëzimit të mësipërm, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuara nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/përfitimin për



një veprim të tillë, u hartua lista e atyre që do të vlerësohen. Lista u nënshkrua nga komisioni i inventarizimit dhe përgjegjësi material.

Në zbatim të pikës 103 të udhëzimit të mësipërm, Komisioni i inventarizimit ,pas verifikimit faktik të të gjithë aktiveve kreu vlersimin e aktiveve që propozohen për nxjerrje nga përdorimi duke hartuar për këtë qëllim proces verbalin e vlersimit, në respektim të plotë të kërkesave të pikës 104 të udhëzimit të mësipërm. Proçesverballi u hartua në tre kopje, u nënshkrua nga komisioni i vlersimit dhe përgjegjësi i materialit dhe u miratua nga titullari i njësisë publike.

Në zbatim të pikës 101 të udhëzimit të mësipërm, është hartuar raporti mbi vlerësimin teknik të pajisjeve kompjuterike, nga specialistë të fushës, të cilët janë shprehur për nxjerrje nga përdorimi të pajisjeve kompjuterike.

Në zbatim të pikës 106 të udhëzimit të mësipërm, kryetari i komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit ka hartuar dhe nënshkruar në tri kopje relacionin e vlersimit, i cili përmban procedurën e ndjekur për vlersimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Aktivitet sipas listës së aktiveve të identifikuar për vlerësim për vitin 2023 janë vlersuar për të dalë jashtë përdorimit pasi:

- a) Kane humbur cilësitë e tyre fizike, kushtet teknike, janë dëmtuar në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;
- b) Kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit dhe nuk mund të riparohen;
- c) Vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm;
- d) Kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvlehtësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;

Rezultatet e propozimeve për nxjerrjet nga përdorimi në procesin e inventarizimit të vitit 2023, sipas njësive shpenzuese, paraqiten si në tabelat bashkëngjitur .

Për vazhdimin më tej të procedurave për nxjerrjet jashtë përdorimit, pas miratimit të projekt-vendimit nga ana juaj më urdhër të Titullarit të Institucionit do të ngrihet komisioni i nxjerrjes dhe asgjësimit të aseteve të propozuara dhe të miratuara për të dalë nga përdorimi në zbatim të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

Bazuar në dokumentacionin e përshkruar me sipër, zyra e financës do të kryej veprimet përkatëse në kontabilitet.


Përgjegjëse finance

Albjola Shahi



Drejtori

Igli Tomçini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
QENDRA KULTURORE

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania,

PROCES-VERBAL

Prot. nr. 59

Date 15.11.2023

PER NXJERRJEN NGA PËRDORIMI I AKTIVEVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA DHE QARKULLUESE PËR VITIN 2023 TË QËNDRES KULTURORE DIBËR.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" , në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008: " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrolli" dhe zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" neni IV , pika 73 deri 106, në urdhërin nr.29 datë 02.10.2023 " Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2023" :

Komisioni i vlerësimit të aktiveve të Qendrës Kulturore parqet rezultatet si më poshtë:

Komisioni bëri inventarizimin fizik të aktiveve për të gjithë punonjësit që kanë në ngarkim aktive. Në përfundim të inventarizimit u hartua dokumentacioni përkatës mbështetur në Udhëzimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve duke cilësuar kushtet për nxjerrjen nga përdorimi.

Në zbatim të pikës 102 të udhëzimit të mësipërm, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuara nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/përfitimin për një veprim të tillë, u hartua lista e atyre që do të vlerësohen.

Në zbatim të pikës 103 të udhëzimit të mësipërm, Komisioni i inventarizimit ,pas verifikimit faktik të të gjithë aktiveve kreu vlersimin e aktiveve që propozohen për nxjerrje nga përdorimi duke hartuar për këtë qëllim proces verbalin e vlersimit, në respektim të plotë të kërkesave të pikës 104 të udhëzimit të mësipërm.

Aktivitet sipas listës së aktiveve të identifikuar për vlerësim për vitin 2023 janë vlersuar për të dalë jashtë përdorimit pasi:

- a) Kane humbur cilësitë e tyre fizike, kushtet teknike, janë dëmtuar në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;
- b) Kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit dhe nuk mund të riparohen;
- c) Vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm;
- d) Kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;

Rezultatet e propozimeve për nxjerrjet nga përdorimi në procesin e inventarizimit të vitit 2023, sipas njësive shpenzuese, paraqiten si në tabelat bashkëngjitur .

Ky proces-verbal së bashku me dokumentat e tjera të nevojshme në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, do të paraqitet pranë Këshillit Bashkiak Dibër për miratim të projekt-vendimit tonë për nxjerrje nga përdorimi i aktiveve sipas tabelës bashkëngjitur.

Komisioni

1. Albjola Shahi (Përgjegjëse finance) Kryetare Komisioni
2. Morena Ruci (Përgjegjëse muzeu) Anëtare e Komisionit
3. Florinda Sela (Përgjegjëse biblioteke) Anëtare e Komisionit
4. Sajmir Xhajku (Inspektor skene) Anetar i Komisionit
5. Manjola Xhidra (Koreografe) Anëtare e Komisionit
6. Edmond Pernezha (Instrumentist) Anetar i Komisionit

36	Biblioteka	Para 2000	218	Pasqyre	cope	850	6	5,100	6	5,100	6	Demtuar
37	Biblioteka	Para 2000	218	Varese metalike rrobash	cope	3,000	1	3,000	1	3,000	1	Demtuar
38	Biblioteka	Para 2000	218	Birmesh skedaresh	cope	180	1	180	1	180	1	Demtuar
39	Biblioteka	Para 2000	218	Shkalle te mesme	cope	2,000	1	2,000	1	2,000	1	Demtuar
40	Biblioteka	Para 2000	218	Tavoline pune	cope	19,100	2	38,200	2	38,200	2	Demtuar
41	Biblioteka	Para 2000	218	Tavoline pune	cope	21,700	1	21,700	1	21,700	1	Demtuar
42	Biblioteka	Para 2000	218	Raft librash	cope	10,000	2	20,000	2	20,000	2	Demtuar
43	Biblioteka	Para 2000	218	Raft gazetash	cope	12,000	1	12,000	1	12,000	1	Demtuar
44	Biblioteka	Para 2000	218	Tavoline pune	cope	15,000	1	15,000	1	15,000	1	Demtuar
45	Biblioteka	Para 2000	218	Skedar 50-kutish	cope	800	1	800	1	800	1	Demtuar
46	Biblioteka	Para 2000	218	Lidhese librash	cope	30	1	30	1	30	1	Demtuar
47	Biblioteka	Para 2000	218	Lidhese gazetash	cope	40	1	40	1	40	1	Demtuar
48	Biblioteka	Para 2010	218	Kompiuter (Hj,duo core,R 2G)	cope	30,000	1	30,000	1	30,000	1	Demtuar
54	Muzeu Peshkopi	Para 2000	218	Perde doku e veshur	cope	120	6	720	6	720	6	Demtuar
55	Muzeu Peshkopi	Para 2000	218	Perde doku te veshura	cope	120	10	1,200	10	1,200	10	Demtuar
56	Muzeu Peshkopi	Para 2000	218	Perde doku te veshura	cope	120	6	720	6	720	6	Demtuar
57	Muzeu Peshkopi	Para 2000	218	Perde doku te veshura	cope	120	10	1,200	10	1,200	10	Demtuar
58	Muzeu Peshkopi	Para 2000	218	Perde kambrik pambuku	cope	6	4	24	4	24	4	Demtuar
59	Muzeu Peshkopi	Para 2000	218	Perde kambrik l bardhe	cope	21	4	84	4	84	4	Demtuar
			1	Shuma 218		778,872		778,872		778,872		
49	Qendra Kulturore	Para 2010	327	Makine kapse	cope	1,000	1	1,000	1	1,000	1	Demtuar
50	Qendra Kulturore	Para 2010	327	Zgjatues	cope	500	1	500	1	500	1	Demtuar
51	Qendra Kulturore	Para 2010	327	Cekic	cope	300	1	300	1	300	1	Demtuar
52	Qendra Kulturore	Para 2010	327	Furce	cope	250	3	750	3	750	3	Demtuar
53	Qendra Kulturore	Para 2010	327	Pinca	pale	500	1	500	1	500	1	Demtuar
54	Qendra Kulturore	Para 2010	327	Dare	pale	600	1	600	1	600	1	Demtuar
55	Qendra Kulturore	Para 2010	327	Bisturi	cope	100	1	100	1	100	1	Demtuar
56	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Pistolete tapicerie	cope	1,000	1	1,000	1	1,000	1	Demtuar
57	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Beze pollester	ml	81	62	5,022	62	5,022	62	Demtuar
58	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Dok jeshil(te ndryshme)	ml	35	4	140	4	140	4	Demtuar
59	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Kova uji	cope	200	3	600	3	600	3	Demtuar
60	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Kova uji	cope	400	1	400	1	400	1	Demtuar
61	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Kove me kapak	cope	200	1	200	1	200	1	Demtuar
62	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Fshese me bisht	cope	220	1	220	1	220	1	Demtuar
63	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Fshesa	cope	100	1	100	1	100	1	Demtuar
64	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Kove pa kapak	cope	300	1	300	1	300	1	Demtuar
65	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Astar mendafshi	ml	46	7	322	7	322	7	Demtuar
66	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Kove me kapak	cope	200	1	200	1	200	1	Demtuar
67	Qendra Kulturore	Para 2000	327	Shkop lecke	cope	100	1	100	1	100	1	Demtuar
68	Biblioteka	Para 2000	327	Fuci kaucuku	cope	2,300	1	2,300	1	2,300	1	Demtuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 13 datë 21/12/2023

“PËR PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN NËNTOR 2023, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957. Date 04.09.2019. “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit, dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 “Për përdorimin e fondit deri në 6%”.

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale pranë Bashkisë Dibër:

I propozon Këshillit të Bashkisë Dibër dhënie e ndihmës ekonomike për muajin Nëntor 2023, 447 familjeve në nevojë, të cilat janë aplikuese në sistemin e ndihmës ekonomike, por nuk janë shpallur fituese për muajin Nëntor për arsye të pikëzimit.

Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kritereve të përcaktuara.

I bashkangjitet këtij Projekt-Vendimi lista emërore me shumën përkatëse sipas Njësive Administrative.

Përgjegjës i Kujdesit Social

Ardit Hoxha

Drejtori Juridik

Ismet Saraci

Drejtori Ekonomik

Çeljeta Zuna

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM

ZV/KRYETARI

Ruzhdi DEDA

